



Informatë për shtyp - 271/04/2020

17.04.2020
faqe 1 nga 2

Qeveria e Landit miraton masa tjera lidhur me pandeminë e koronavirusit

Zyra e Shtypit të Kancelarisë
Shtetërore
40213 Düsseldorf
Telefon 0211 837-1134
0211 837-1405
oder 0211 837-1151

Rregullat e reje vlejné pjesërisht që nga 20 prilli / Kryetari i Qeverisë Laschet: Distanca dhe mbrojtja do të mbesin edhe më tutje kriter dhe rregull e përditshmërisë sonë

presse@stk.nrw.de
www.land.nrw

Qeveria e Landit informon:

Kabineti i Landit ka vendosur të enjten, më 16 prill 2020, masa tjera lidhur me pandeminë e koronavirusit. Ministri i Shëndetësisë Karl-Josef Laumann ka nënshkruar ndryshimin e Rregullores për Mbrojtjen nga Korona, e cila ka hyrë në fuqi më 20 prill.

Kryetari i Qeverisë Armin Laschet: „Federata dhe Landet janë dakorduar për një rrugë të përbashkët të kthimit në një normalitet me përgjegjësi të plotë. Që ne mund ti marrim këta hapa duhet falënderuar në rend të parë qytetarët: Çdo njëri ka kontribuar përmes sjelljes, përmbajtjes së rregullave dhe mënjanimi të dhembshëm të kontakteve sociale në ngadalësimin e përhapjes së koronavirusit. Kjo lidhje e fortë e brendshme në shoqërinë tonë më ka impresionuar dhe unë ju falënderohem përzemësisht për këtë. Tani më vlen që t'i mbajmë sukseset e arritura në zbutjen e pandemisë dhe në të njëjtën kohë të shkojmë me hapa me përgjegjësi të plotë dhe koncentrim që të arrihet ngadalë deri te jeta normale zyrtare. Distanca dhe mbrojtja do të mbesin edhe më tutje kriter dhe rregull e përditshmërisë sonë“

Me Rregulloren për Mbrojtjen nga Korona miratohen tani masat, për të cilat janë dakorduar të mërkurën Kryetarët e Qeverive të Landit si dhe Kancelarja.

Posaçërisht në lidhje me bizneset kanë pasuar disa ndryshime. Tani më mund të hapen që nga 20 prilli 2020 përpos disa bizneseve që kanë qenë të hapura edhe të gjitha libraritë, bizneset për tregti për kafshë, bizneset e ndërtimit dhe kopshteve dhe bizneseve tjera (p.sh. bizneset me lule, të objekteve sanitare, të gjërave të hekurta, të gjërave gëlqerore, të

dysHEMEVE dhe të lëndëve të ndërtimit). Edhe bizneset e mobileve, dyqanet për gjëra të fëmijëve dhe vendet e shitjes për tregti me automjete dhe me bicikleta mund të hapen prapë. Poashtu mund të hapen edhe bizneset tjera të tregtisë në NRW, nëse hapësira e vendshtijes së tyre nuk e kalon sipërfaqen prej 800 m². Të gjitha dyqanet janë të detyruara, që të marrin masat lidhur me higjenën, drejtimin e konsumatorëve në hyrje, mënjanimin e pritjeve të gjata dhe garantimin e distancës prej 1,5 metrash në mes të personave.

Duke u bazuar në vendimet e Kancelares dhe Kryetarëve të Landeve Ministria për Arsim dhe Shkolla planifikon një rihapje të kujdesshme dhe në etapa të shkollave. Më 20 prill do të hapen së pari shkollat e klasave më të larta, por së pari vetëm për mësuesë dhe menagjmentin e shkollës për të mund përgaditur hapjen e shkollës. Nga e enjtja, 23 prilli 2020, mund të vijnë vullnetarisht në shkollë nxënës, që i kanë provimet e rëndësishme për kryerjen e nivelit të parashikuar shkollor. Varësisht nga zhvillimi i infeksioneve mund të hapen shkollat hap pas hapi që nga 4 maji 2020 – së pari nxënësit e klasës së katërt të shkollës së ulët për t'i përgaditur nxënësit, të cilët duhet të kalojnë në shkollat pasuese në verën që po vjen. Kjo hapje e parë e shkollave është e mundshme, vetëm nëse përmbahen rregullat e ashpra për mbajtjen e higjenës dhe mbrojtjes nga infektimi. Përpos detyrimeve për plane shkollave do t'u dërgohen në kohë të shkurtë edhe rekomandimet e analizuara specifikisht për veprim në mbajtjen e higjenës nën kushtet e pandemisë. Shëndeti i nxënësve dhe mësuesëve si dhe i gjithë personelit shkollor ka prioritet të lartë për Qeverinë e Landit.

Rregullorja e ndryshuar e Mbrojtjes nga Korona vlen për hapësirën e kohës prej 20.04. deri më 03.05. 2020. Në fund të prillit do të takohen prapë Kancelarja dhe Kryetarët e Qeverive të Landeve në një takim tjetër për t'u këshilluar lidhur me hapat e mëtejme.

Ky tekst i shtypit mund të gjendet përmes faqes së internetit të Qeverisë së Landit www.land.nrw

[Udhëzime të përgjithshme për mbrojtjen e datave](#)